

Prof. dr. Muhamet SHATRI

BARDH ISUF GASHI, FIGURË E SHQUAR E LËVIZJES KOMBËTARE

Bardh Isufi, njëra nga figurat e shquara të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, që ka zënë vend në kujtesën tonë historike kombëtare, u lind në vitin 1875 në fshatin Arbanë (Orrobërdë) të Podgurit, në një familje të njohur atdhetare. Qysh i ri ai u inkadrua në Lëvizjen Kombëtare dhe tërë jetën ia kushtoi çështjes së çlirimit dhe bashkimit të atdheut. Për këtë ideal, sa të lartë aq edhe fisnik, ai u flijua duke luftuar burrërisht me pushkë në dorë.

Bardh Isufi njihet si pjesëmarrës i ngjarjeve të rëndësishme mbarëkombëtare: i Lidhjes Shqiptare të Pejës, të kryesuar nga Haxhi Zeka; i Kuvendit II të Verrat e Llukës (1910); i Kryengritjes Antiosmane të vitit 1912, si bashkëluftëtar i denjë i një plejade të tërë drejtuesish të njohur dhe figurash të ndritura të historisë sonë kombëtare si Isa Boletini, Hasan Prishtina, Sadik Rama, Zefi i Vogël, Azem Bejta, Adem Voca, Shaban Polluzha, prof. Ymer Berisha, Ajet Gërguri, prof. Gjon Serreqi, Avdi Shala e të tjerë.

Bardhi së bashku me Isuf Veselin e Kryedrinit (Radavcit) e shumë burra të Podgurit luftuan me heroizëm të pashoq kundër ushtrive pushtuese serbo-

malazeze në vjeshtën e vitit 1912. Edhe në vitin 1918 Bardhi u rreshtua përkrah luftëtarëve të guximshëm kundër forcave policore-ushtarake të Mbretërisë SKS, të cilat po depërtonin tinëzisht në Kosovë.

Pas ripushtimit të Kosovës nga ushtria serbe, për shkak të ndjekjeve të pushtuesit serb, ai u detyrua të strehohej në Shkodër, por pa e ndërprerë për asnjë çast veprimtarinë në dobi të Kosovës së martirizuar. Edhe në Shkodër ai do të jetë përkrah atdhetarëve të tjerë e më të njohur, në mbrojtje të çështjes së Shqipërisë etnike, midis pjesëmarrësve të Kuvendit që më 7 nëntor 1918 themeluan organizatën atdhetare e politike Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës.

Si njëri ndër veprimtarët më aktivë të këtij Komiteti, Bardh Isufi luftoi pa u epur për mbrojtjen dhe konsolidimin e shtetit shqiptar dhe për çlirimin e Kosovës e të trevave të tjera shqiptare nga zgjedha serbe. Për realizimin e këtyre idealeve, ai mori pjesë në Kryengritjen e Lugut të Drinit, të drejtuar nga Sadik Rama e Zef Gjidoda, si edhe në shumë aksione të armatosura kundër pushtetit okupues të Mbretërisë SKS.

Gjatë viteve 1921-1923 bashkë me Bajram Currin, Hasan Prishtinën, Azem Bejtën, Kerin e Sadri Bardhit, Sadik Ramën dhe mëse 2.000 luftëtarë të armatosur qëndroi në "Zonën Neutrale të Junikut". Aty gjeti mikpritje në familjen bujare të Adem Makës dhe pati rastin të njihet për së afërmi më shumë drejtues me emër nga radhët e qëndresës shqiptare.

Pikërisht në këtë kohë Bardh Isufi, për shkak të veprimtarisë së njohur atdhetare, u vu në qendër të goditjeve të pushtuesit serb. Bandat çetnike të drejtuara nga kriminelit famëkeq Miliq Kërstiq ia

dogjën shtëpinë dhe ia grabitën 12 hektarë tokë, që ua dhuruan dy familjeve koloniste.

Pas shpartallimit të Zonës Neutrale të Junikut, së bashku me shumë udhëheqës të çetave të armatosura dhe me luftëtarë të lirisë u detyrua të kalonte në ilegalitet për të vazhduar qëndresën e armatosur kundër pushtuesit serb dhe bandave kriminale çetnike në Kosovë dhe në trevat e tjera shqiptare. Ai u rreshtua përkrah Ramë Bekës, Hajdin Zekës, Tahir Elshanit, Ali Shabanit, Qazim dhe Azem Vragës-Mulajt, Malë Bakut-Hakajt, Sali Hoxhës-Maksutajt, Rexhë Haxhisë, Hysen Murselit, Ramë Muratit, Tahir Kadrisë e prijësve të tjerë, në luftimet e ashpra për mbrojtjen e Arbanës, njëres prej fortifikatave të pamposhtura të çetave të lirisë.

Bardh Isufi ishte përkrah shokëve të tij të idealit dhe luftoi me trimëri, si pjesëmarrës aktiv i Lëvizjes për Çlirim e Bashkim Kombëtar, të udhëhequr nga heroi legjendar i Drenicës Azem Bejta. Pas shpartallimit të kësaj lëvizjeje, në vitin 1930, u detyrua të largohej me familje nga Kosova dhe të vendosej në Shënavlash të Durrësit. Aty qëndroi 11 vjet, por ruajti të pashuar mallin për Kosovën dhe për bashkëfshatarët e tij të Arbanës. Dëshmi më e qartë e këtij malli ishte veprimtaria e tij atdhetare në dobi të kombit e të zgjimit kombëtar të bashkatdhetarëve të tij, të cilën nuk e ndali për asnjë çast; angazhimi i tij për dërgimin e abetareve dhe të librave shqip në Kosovë, të cilat miku dhe bashkëveprimtari i tij Cak Lubova-Kajtažaj i shpërndante në Pejë e Podgur.

Pas shpartallimit të Jugosllavisë, në pranverën e vitit 1941, si shumica e kosovarëve, që kishin qënë të detyruar të jetonin larg vendlindjes, por duke ruajtur

në gji mallin e pashuar për trojet dhe tokën e të parëve, u kthye në vendlindje dhe u vu në dispozicion të pushtetit dhe të administratës shqiptare që u krijua në Kosovë. Bardh Isufi, si njeri me një të kaluar të pasur e të çiltër atdhetare, do të afirmohet si një personalitet me autoritet dhe që gëzonte respektin e bashkëkombësve.

Së bashku me Bajram Gashin e Uçës dhe veprimtarë të tjerë të çështjes kombëtare luftoi për zhdukjen e kriminelëve dhe bandave serbo-çetnike, që i kishin sjellë dëme e grabitje të panumërta, arbitraret të pashembullta, popullit të kësaj ane dhe të mbarë Kosovës.

Si burrë me autoritet dhe atdhetar i devotshëm Bardh Isufi u vu në krye të Islihatit (Komisionit për Pajtimin e Gjaqeve dhe Ngatërresave në Nënprefekturën e Istogut). Ai bashkë me nënkryetarin Llesh (Gjon) Lleshajn e Zallkuqit (Zllakuqanit), Ibrahim (Sali) Shatrin e Kushtrimit (Tomocit), Mulla Sadri Gashin e Uçës, Vesel (Mehmet) Rracin e Sukasit (Siçevës), Feriz Bajraktarin e Kryedrinit, Halit (Halil) Elshanin e Dasamit (Staradranit), Ramë (Tahir) Rexhajn e Rranzës (Cerrcës), Idriz (Daut) Balajn e Verrishtës (Llugave të Isniqit), Hasan (Rexhë) Salihajn e Gashit (Shushicës) dhe Shaban (Rrustem) Dreshajn e Tedelit (Vrellës) pajtoi shumë familje që ishin në hasmëri.

Në popull ka mbetur i gjallë kujtimi se atje ku depërtonte fjala dhe jepej Besa e Bardh Isufit dhe e të gjithë këtyre burrave të urtë, kurrë më nuk dëgjohej ndonjë zënkë dhe nuk ndodhte të dëgjohej për hasmëri apo për vrasje. Kjo punë e mbarë, kjo Besë e madhe që lidhej në ato vite kur kishte shumë probleme të

mëdha që kërkonin zgjidhje, i ka kontribuar, ashtu siç ka ndodhur gjithmonë në traditën popullore, forcimit të unitetit kombëtar, fuqizimit të Levizjes Kombëtare, krijimit të parakushteve për luftë të armatosur e të përbashkët kundër armiqve shekullorë të kombit. Këtë traditë, sa të lashtë aq edhe të dobishme do ta ripërtërinte në vitet '90 edhe profesori ynë i nderuar dhe i respektuar në gjithë Kosovën Anton Çetta.

Në ato vite të vështira e të stuhishme të Luftës së Dytë Botërore, Podguri u rreshtua i tëri përkrah Lëvizjes Kombëtare që synonte të ruante tërësinë e trojeve etnike dhe ai, falë pozicionit të favorshëm gjeostrategjik, qëndroi dhe kontribuoi shumë për mbrojtjen e kufirit etnik me Malin e Zi dhe me Serbinë.

Burrat e kësaj ane iu përgjigjën pa hezituat thirrjes së atdheut, sakrifikuan madje edhe jetën për të mbrojtur jo vetëm këto treva, por edhe për t'u shkuar në ndihmë rajoneve të kërcënuara nga bandat çetnike. Vullnetarët nga Podguri do t'i gjejmë përkrah vëllezërve të tyre në Plavë e Guci, në Pasbjeshkë (Sanxhak) dhe në trevat e tjera kufitare, sepse ata janë pjesë e pandarë e etnisë shqiptare, që iu kundërvu me guxim, kurajo e vetmohim falangave serbo-malazeze. Dëshmi e sakrificës sublime ishte edhe jeta dhe veprimtaria e birit të shquar të këtyre anëve, Bardh Isufit.

Në vjeshtën e vitit 1944 forca të shumta serbe, malazeze, maqedone e bullgare, fatkeqësisht të ndihmuara edhe nga partizanët e Enver Hoxhës, përkundër qëndresës heroike të djalërisë shqiptare, riokupuan Kosovën dhe trevat e tjera etnike. Por Bardhi me bashkëlufëtarët e tij, sikundër edhe i gjithë

populli shqiptar, nuk u pajtua me pushtuesit e vjetër që ishin të veshur me petkun e ri.

Në dimrin e zi të vitit 1944-1945 edhe në Istog e rrethinë, sikundër edhe në mbarë Kosovën dhe trevat etnike, OZN-a gjakatare dhe brigadat serbo-malazeze ushtruan terror e gjenocid të paparë mbi shqiptarët. Në rrethana të tilla forcat atdhetare organizuan sulme për çlirimin e Ferizajt, Gjilanit dhe të Janjevës, por, siç është e njohur, ato dështuan. Gjatë janarit dhe shkurtit 1945 u organizua Lufta e Shalës dhe ajo e Drenicës nën udhëheqjen e Adem Vocës e Shaban Polluzhës, por edhe këto përfunduan me disfatën e forcave atdhetare.

Mirëpo, me gjithë terrorin dhe masakrat e pushtuesit, qëndresa e popullit shqiptar, lufta e tij për liri e për të drejta kombëtare dhe për bashkim kombëtar nuk pushoi për asnjë çast. Nga pranvera e vitit 1945 udhëheqjen e qëndresës shqiptare e mori në dorë LNDSH-ja, e cila e shtriu rrjetin e vet organizativ në të gjitha trevat e pushtuara shqiptare. Bardh Isufi pasi e kaloi dimrin në ilegalitet të thellë në familjen bujare të Fazli Ismail Mulajt nga Arbana, doli në mal dhe iu bashkua grupit të qëndresës shqiptare të kësaj ane. Ky grup trimash të paepur përbëhej nga Hajdin Zeka, Bik Bihori i Peshterit dhe 40 luftëtarë të tjerë që bashkëvepronin me grupet e Demë Ali Pozharit, Ukë Sadikut e prof. Ymer Berishës, Mehmet agë Rashkocit, Qazim Bajraktarit, Ramë Binakut, Zhuk Haxhisë, Rizë Zymerit, Ndue Përllëshit, Avdi Smajlit të Martinajve të Plavës, Zaim Smajlit nga Uglla, Adem Shabanit të Metehit të Plavës, Bajram Gashit e Ramë Alisë, Bekë (Adem) Shalës, Demë Hajdinit, Bajram Smakajt, Tal Kurteshit, etj. Veprimtaria e këtij grupi koïncidonte

edhe me qëndresën heroike të mbarë Kosovës, si dhe të viseve më lindore shqiptare ku me guximin dhe sakrificën sublime prinin Adem Gllavica, Hysen Tërpeza, Hakif Rimanishta, Ahmet Selaci, Ukshin Kovaçica, Bislim Bajgora, Isuf e Faik Boletini, Osman Bunjaku, Bahtir Dumnica, Rexhep Kabashi, Hajdin Matoshi, Avdyl Dura, Murat Labunishti, Syle Hotla, Xhemë Gostivari, dy Mefailat e Zajazit, etj.

Përkundër qëndresës heroike të atdhetarëve të devotshëm të trojeve tona, për fat të keq të kombit tonë, raporti i forcave në prag të fundluftës së Dytë Botërore ishte në disfavor të forcave atdhetare shqiptare. Më 20 prill 1945 dy çeta të Batalionit 1-rë të Brigadës VI të Malit të Zi, rrethuan vendstrehimin e Bardhit dhe të shokëve të tij në vendin Delibuell të Bjeshkës së Thatë. Lufta ishte e ashpër dhe e pabarabartë. Bardhit, edhe pse në moshë të shtyrë, nuk i shkonte ndërmend të dorëzohej. Ai ra duke luftuar me armë në dorë ashtu siç i ka hije ushtarit të përbetuar të atdheut, ashtu siç ishte betuar përpara Isa Boletinit dhe Bajram Currit.

Repartet e Brigadës shqiptarëvrasëse deshën ta marrin trupin e pajetë të Bardhit dhe ta ekspozonin në Istog, ashtu siç kishin vepruar edhe me kufomat e atdhetarëve Bajram Gashi, Ramë Alia dhe të të birit Salihut, të cilat Sahit Zatriçi pasi i kishte fyer në mënyrën më banale, i kishte shqelmuar mu në qendër të këtij lokaliteti. Por shokët e Bardhit Sadri (Smajl) Zeqiraj dhe Qerim (Sadri) Zeqiraj nga Gurrasi (Sudenica), Qazim Vraga-Gashi, Fazli Sylja, Hajdin (Zekë) Muzlijaj, Sali Hoxha-Maksutaj, Ali Shabani, Malë Baku-Hakaj nga Arbana, Sejdi (Zenun) Shala nga Nëngurra (Lubozhda), Shaban (Ukë) Hajdaj nga Thana (Lubova), Musë (Nimon) Mehaj, Bajram

e Hazir (Hysen) Gashi të Përgodës (Prigodës), Sadri (Xhemë) Metaj dhe Hetem e Ali Metaj të Drinasit (Kashicës), Avdi Uka i Temalit (Kamenicës), Qerim Taja-Ukaj i Kaliqanit etj., nuk lejuan që armiqtë t'ia marrin kufomën dhe Bardhin e varrosën të Stanet e Bajrushëve në Bjeshkën e Kaliqanit. Pas një kohe OZN-a likuidoi edhe kushëririn e Bardhit, Sali Hoxhën-Maksutajn, veprimtar i shquar i LNDSH-së, si dhe djalin e të vëllait të Bardhit, Tahir Maksutajn.

Organet e pushtetit serbokomunist, ashtu siç kishin vepruar më parë organet e Jugosllavisë së paraluftës, vendosën të konfiskonin pasurinë e Bardh Isufit, si edhe të shumë luftëtarëve të tjerë të lirisë. Por, pavarësisht nga të gjitha këto veprime, familja e Bardhit arriti të mbijetojë vetëm falë angazhimit dhe humanizmit të miqve e familjeve atdhetare të Podgurit dhe më gjerë. Tani ka ardhur koha që prona e plaçkitur nga organet e një pushteti okupues e antishqiptar t'u kthehet pasardhësve të tij.

Veprën atdhetare të Bardh Isufit dhe të luftëtarëve të Arbanës e vazhduan edhe gjeneratat e mëvonshme. Kjo veprimtari u zgjerua dhe u intensifikua sidomos në vitet e 90-ta kur nëpërmjet LDK-së, të udhëhequr me urti e guxim nga presidenti i Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, u shndërrua në Lëvizje të fuqishme për çlirim kombëtar. Kjo lëvizje kulmoi me Luftën Çlirimtare të Kosovës të viteve 1998–1999. Në këtë luftë mbinjerëzore edhe vajzat e djemtë e kësaj ane me trimëri dhe sakrifica ngritën edhe më lart nderin dhe lavdinë e Arbanës heroike.

Në altarin e lirisë, në panteonin e të rënëve, kanë zënë vend edhe bijë e luftëtarë nga ky fshat, të cilët i kujtojmë e do t'i kujtojmë vazhdimisht me respekt të

thellë. Me mirënjohje të veçantë sot përkulemi përpara veprës së dëshmorëve: Myrvete (Sali) Maksutaj, Nazmi (Haxhi) Muzlijaj, Arton (Shaban) Zogaj, Qazim (Ali) Hakaj, Nexhmedin (Brahim) Hakaj dhe Muharrem (Haxhi) Gashi.

Lavdi dhe respekt veprës atdhetare të deshmorit Bardh Isufi.

Lavdi luftëtarëve dhe dëshmorëve të Arbanës martire, të Kosovës dhe të viseve të tjera etnike që luftuan dhe u flijuan për lirinë e atdheut.

